



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit **Granit Gjana**, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, në dy raste, parashikuar nga neni 258/2 i Kodit Penal”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Etleva Deda, Erjon Çela dhe Flojera Davidhi, me vendimin Nr. **71**, datë **27.11.2024** vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Granit Gjana**, për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, parashikuar nga neni 258 paragrafi i dytë i Kodit Penal, (për procedurën e prokurimit me nr. REF-56811-01-24-2023, me objekt “*Blerje karburanti*”) dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Granit Gjana**, për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, parashikuar nga neni 258 paragrafi i dytë i Kodit Penal, (për procedurën e prokurimit me nr. REF-70621-05-25-2023, ne objekt “*Blerje karburani*”) dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
3. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit **Granit Gjana** me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.
4. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Granit Gjana** me 1 (një) vit burgim.
5. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit **Granit Gjana** për një periudhë prej 2 (dy) vitesh, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.
6. Urdhërohet i pandehuri **Granit Gjana** të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës Tiranë dhe të mos marrë kontakt me persona të dënuar.
7. Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin **Granit Gjana** për 5 (pesë) vjet.
8. Në bazë të neneve 261 pika 1 gërma “b” dhe 389 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, shuarjen e masës së sigurimit personal “*Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik*”, parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale, të

caktuar ndaj shtetasit **Granit Gjana** me Vendimin nr. 133, datë 01.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

9. Në lidhje me provat materiale, Gjykata disponon në mbështetje të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, si më poshtë:
- Provat materiale të sekuestruara sipas procesverbaleve të sekuestrimit datë 12.07.2023, që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit me nr. REF-56811-01-24-2023 dhe nr. REF-70621-05-25-2023, t'i kthehen autoritetit kontraktor, Bashkia Kukës.
 - 1 (një) CD me materialet e përgjimit të qëndrojnë në fashikullin e gjykimit.
10. Shpenzimet procedurale të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak, në masën ***** lek, gjatë seancës paraprake dhe gjatë gjykimit (sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi), i ngarkohen të pandehurit.
11. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të ekzekutojë këtë vendim.
12. Kundër vendimit lejohet apel brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 27.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar